

CONTENTS / PERMBAJTJA

AmCham News/Lajme

Aspiring to a Single Market

Aspiratat për një treg të përbashkët..... 6-11

AmCham General Assembly

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë..... 12-17

AmCham Argues Against 'Tax Experts'

Dhoma Amerikane Kundër "Ekspertit Fiskal"..... 18-23

AmCham Presents Business Concerns to Tax Director

Dhoma Amerikane Flet me Drejtoren e Tatimeve për Problematikat e Biznesit..... 24-27

Business Forum with Customs General Director Belinda Ikonomi

Forum Biznesi me Drejtoren e Përgjithshme të Doganave Belinda Ikonomi..... 28-31

AmCham Discusses Local Taxes with Tirana Municipality

Dhoma Amerikane Flet për Taksat Vendore me Bashkinë e Tiranës..... 31-35

TIS : 25 Years of Success

TIS : 25 Vite Sukses..... 36-37

AmCham Business Forum in collaboration with Deloitte Albania

AmCham Forum Biznesi në bashkëpunim me Deloitte Albania..... 38-41

Leader-for-a-Day Program at AmCham Albania

Lider për Një Ditë tek Dhoma Amerikane e Tregtisë..... 42-43

Member News/ Lajme Anëtarësh..... 44-47

Economy/Ekonomi

PwC Tax Workshop on Retail and Consumer Goods Industry

PricewaterhouseCoopers Workshop "Shitjet me pakicë dhe mallrat e konsumit"..... 48-51

AMCHAM BOARD



President

Mark C. CRAWFORD
*Aksioner International
Securities Brokerage*



Vice-President

Genti DACI
ABCCom



Secretary

Genci LIKOSKENDAJ
*CCS Computer & Copier
Systems*



Treasurer

Alketa URUÇI
Boga & Associates

Board Members



Adrian SHEHU
T.C.N



Avni PONARI
SIGAL Uniqa Group Austria



Elton ÇOLLAKU
*Financial Union
Tirana-Western Union*




Loreta PEÇI
*Pricewaterhouse Coopers
Audit*



Artan BOZO
Bozo & Associates



Enio JAÇO
CBS Creative Business Solutions



Brandt W. HOFFMAN
G&H Partners



Enida BEZHANI
AmCham Albania

NDËR KOMPANITË E PARA NË TREGUN FINANCIAR NË SHQIPËRI QË KA REALIZUAR:

Automatizim të plotë të procesit të kredidhënies
nëpërmjet përdorimit të tabletave;

Automatizim të pagesave të kësteve
mujore nëpërmjet **M-Pesa** dhe **Pay&Go**;



Emetim Obligacionesh
Korporative Afatgjata;

www.noa.com.al

Për çdo informacion telefononi në:

068 400 14 03

SUSTAINING MEMBERS

ANETARE PRESIDENCIALE

ASPIRING TO A SINGLE MARKET

The American Chamber of Commerce in Albania in cooperation with AmCham Kosovo and the Monitor magazine as well as businesses represented by them have appealed to politicians to take into account solutions offered by the business community and opportunities offered by cooperation between the Albanian and Kosovo governments to make this dream come true.

AmChams in Albania and Kosovo, in cooperation with Monitor magazine, organized the Aspiring to a Single Market, Albania-Kosovo Conference. Designed in three panels, the conference aimed to identify trade and investment issues through presentations by Albanian and Kosovo experts, as well bringing together trade and investment enterprises from both countries. The final panel brought together Albania's Economy and Trade Minister Milva Ekonomi and her Kosovo counterpart, Hykmete Bajrami, facing AmCham Albania and AmCham Kosovo representatives as well as the Monitor magazine publisher, to discuss concrete ways businesses think they can operate the same way in both markets and how official policies can make these solutions easier.



TRADE POTENTIAL AND ISSUES

Addressing the opening panel, trade analyst Ilir Ciko said the structure of trade exchanges between the two countries remains very poor and non-diversified, reflecting the respective economic realities. On the other hand, despite the high pace of trade exchanges through the border, sporadic conflicts limited to specific products -- such as customs reference prices, the rules of origin, sanitary and phytosanitary measures and standards -- have somewhat overshadowed achievements.

Entrepreneur Alban Zusi said trade exchanges with Kosovo are carried out by big businesses engaged mainly in brick and cement production, with their total number at about 15.

"Unfortunately small and me-

dium-sized businesses are not engaged in the exchanges as you need big loads if going to Kosovo, otherwise it's profitless. For small and medium-sized businesses, there are many payments reaching up to 17,000 lek (\$132). In order to sell 100,000 lek (\$777) of goods, you have to pay 17,000 lek in customs duties which increases costs and makes trade with Kosovo for SMEs profitless," said Mr. Zusi. According to him, there is also the non-tariff barrier issue.

"This way of operating has strengthened big businesses, but curbed small ones. It is much more profitable working with the French and Austrian markets rather than with Kosovo exactly because of these issues," added Zusi.

Arian Zeka, the head of the

American Chamber of Commerce in Kosovo, said the issues should have already been tackled with understanding and that there has been dialogue, but soon after the dialogue, problems still reappeared, bringing the example of Birra Peja beer.

"Actions undertaken by both governments run counter to the cooperation spirit promoted between the two countries. It makes no sense for the two countries to impose barriers upon each other at a time when they can't compete with the same products, but have complementary products," said Mr. Zeka.

The head of the Kosovo AmCham proposes the harmonization of phytosanitary certificates, saying it is useless talking about cooperation unless this is

achieved.

Saimir Sinani, a representative of Albania's customs administration, said customs authorities had a tendency of giving a priority to every element of easing procedures and reducing costs.

"The joint customs transit with Kosovo and the use of simplified procedures with Kosovo has been operational for some time," Mr. Sinani said.



ASPIRATA PËR NJË TREG TË PËRBASHKËT



Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri në bashkëpunim me Dhomen Amerikane të Kosovës dhe Revistën Monitor i janë vënë përballë me bizneset e tyre politikës, duke i kërkuar të marrë në konsideratë zgjidhjet që ofron biznesi dhe mundësitë që ofron bashkëpunimi mes dy qeverive për ta bërë të mundur këtë ëndërr.

Dhoma Amerikane e Tregtisë së Shqipërisë dhe Dhoma Amerikane e Kosovës, në bashkëpunim me Revistën Monitor kanë organizuar Konferencën “Aspirata për një treg të përbashkët, Shqipëri-Kosovë”. Konferenca e konceptuar në tre panele ka synuar të identifikojë problemet e tregtisë dhe investimeve, përmes prezantimeve të ekspertëve nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe të vërë përballë bizneset nga të dyja vendet në fushat e tregtisë dhe investimeve. Në panelin e fundit, dy ministrat përkatës të ekonomisë, znj. Milva Ekonomi dhe znj. Hykmete Bajrami kanë qenë përballë përfaqësuesve të Dhomës Amerikane në Shqipëri dhe Dhomës Amerikane në Kosovë si dhe të Botuesit të Monitor, për të diskutuar mbi rrugët konkrete në të cilat biznesi mendon se mund të ndihet njësoj në të dy tregjet dhe politika mund t’i facilitojë këto zgjidhje.

TREGTIA, POTENCIALET DHE PROBLEMATIKAT

Në panelin e parë, duke folur mbi tregtinë analisti i tregtisë, z. Ilir Ciko tha se struktura e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve mbetet tepër e varfër dhe e përqendruar, duke pasqyruar realitetet ekonomike të tyre. Nga ana tjetër, me gjithë ritmet e larta të rritjes së tregtisë përmes kufirit shqiptar, konfliktet sporadike e të kufizuara tregtare për produkte të veçanta, si referencat doganore, rregullat

e origjinës, masat sanitare e fitosanitare dhe standardet, kanë zbehur disi arritjet. Alban Zusi, sipërmarrës, gjatë fjalës së tij tha se tregtia me Kosovën realizohet nga bizneset e mëdha, që janë në fushën e tullave, çimentos, etj., e që në total janë rreth 15.

“Bizneset e vogla dhe të mesme, fatkeqësisht nuk punojnë, sepse të shkosh në Kosovë duhen ngarkesa të mëdha, ndryshe nuk ka leverdi. Për bizneset e vogla dhe të mesme pagesat janë të shumta dhe shkojnë deri në 17,000 lekë. Për të shitur 100,000 lekë duhet të shpenzosh 17,000 lekë taksa doganore, çka e rrit koston dhe e bën të palevërdishe tregtinë me Kosovën për bizneset e vogla dhe të mesme”, tha z. Zusi. Sipas tij, është edhe çështja e barrierave jotarifore. “Kjo mënyrë e të punuarit ka fuqizuar bizneset e mëdha, por

ka penguar ato të vogla. Ka më shumë leverdi të punosh me tregjet e Francës e të Austrisë sesa me Kosovën, pikërisht për shkak të këtyre problemeve”, tha Zusi. Ndërsa drejtuesi i Odës Amerikane të Kosovës, Arian Zeka, tha se problemet duhet të zgjidheshin me mirëkuptim dhe se dialogu ka ekzistuar. Por, ai thekson se menjëherë pas dialogut janë shfaqur problemet, duke përmendur rastin e Birrës Peja. “Veprimet që merren nga qeveritë janë në kundërshtim me frymën e bashkëpunimit që promovohet mes dy vendeve. Është pa kuptim që dy vendet i vënë barrierë njëra-tjetrës, kur ato as nuk konkurrojnë dot me të njëjtat produkte, përkundrazi i kanë plotësueset”, tha z. Zeka.

Ai propozon që të harmonizohen certifikatat fitosanitare, pasi nëse nuk arrihet të bëhet

kjo, është e kotë që të flitet për bashkëpunim. Saimir Sinani, përfaqësues i doganave shqiptare tha se dogana ka qenë e prirur që çdo element për lehtësimin e procedurave dhe uljen e kostove ta shohë me përparësi. “Prej kohësh funksionon traziti i përbashkët me Kosovën dhe përdorimi i deklaratsë së thjeshtuar”, tha z. Sinani.



WHAT HOLDS INVESTMENTS BACK

AmCham Kosovo's Era Jashari said Kosovo Central Bank data shows Albanian investments in Kosovo reached €28.6 million in 2016, accounting for 12 percent of the total of €40.1 million. In total, the cumulative stock of Albanian investment in Kosovo since 2007 has reached €193 million.

"In 2015, Albania ranked among the top five investors in Kosovo after Switzerland, Turkey, Germany and Austria," said Jashari. However, the FDI performance has been poor and mainly focused on non-tradable sectors such as real estate.

BASED ON THE ECONOMIC ACTIVITY, ALBANIAN INVESTMENTS IN KOSOVO FOR 2016 WERE MAINLY FOCUSED ON REAL ESTATE, FINANCIAL INTERMEDIATION, WHOLESALE AND RETAIL TRADE AND THE PROCESSING INDUSTRY.

According to Ms. Jashari's presentation, annual investments are dominated by real estate, construction and financial intermediation. From 2013 to 2016, investments in real estate and construction were at €28.1 million and €23.6 million respectively and reached €20.3 million in financial intermediation.

Meanwhile, Kosovo investments in Albania reached €15.6 million in 2016. The higher level of Albanian investments in Kosovo compared to the other way round raises question marks whether the investment climate in Albania is less favorable compared to Kosovo's.

From 2013 to 2016, Kosovo in-



vestments in Albania real estate held the lion's share at €23.8 million followed by trade services at €7.2 million.

Some 903 Albanian businesses operate in Kosovo while there are about 600 Kosovo businesses in Albania. Ms. Jashari said the bankruptcy of Kosovo businesses is a common phenomenon in Albania where there is tough competition with Greek and Italian businesses.

She noted that Kosovo businesses face most problems with construction permits and paying taxes. "Investments in both countries are much lower than the potential level, despite the infrastructure upgrade," said Jashari, adding that customs procedures should also improve.

Avni Ponari, the head of Sigal insurer, said both Kosovo and Albania have the same nature and organization form. "The insurance industry is underdeveloped in the whole region. The per-

capita insurance rate in Albania is at €25, in Kosovo at €50 and at €700 in Croatia. In Kosovo we pay a 5 percent turnover tax and because of this tax insurance companies are not making a profit there," said Mr. Ponari.

Kosovo's Economic Development Minister Blerand Stavileci said both countries are highly dependent on imports and underdeveloped industries. Businesses target short-term and quick profits by avoiding the manufacturing industry. "There is need for progressive infrastructural links in telecommunication, energy etc." said Stavileci.

As far as energy is concerned, the minister said Kosovo has reached a deal with an American company to build a 450 MW thermal power plant. The minister also said he was optimistic of the functioning of the Albania-Kosovo power exchange.

Irena Beqiraj, an economic ad-

visor to Albanian Prime Minister Edi Rama, said the Western Balkans mainly attracted investment in services until 2015. Foreign investors require macroeconomic stability, qualified workers, labor security, political stability and no ethnic tensions, she said.

Beqiraj said certificates must be unified and the Albanian government is working on this.



INVESTIMET, ÇFARË I PENGON

Era Jashari, nga Dhoma Amerikane e Tregtisë së Kosovës, tha se sipas statistikave nga Banka Qendrore e Kosovës, investimet shqiptare në Kosovë në vitin 2016 ishin 28.6 milionë euro (12% e totalit), nga 40.1 milionë euro në 2015-ën. Në total, investimet kumulative nga Shqipëria në Kosovë, nga viti 2007 kanë arritur në 193 milionë euro.

“Në vitin 2015, Shqipëria u rendit ndër pesë investitorët kryesorë të Kosovës, pas Zvicrës, Turqisë, Gjermanisë dhe Austrisë”, tha ajo. Gjithsesi, performanca e IHD-ve është e dobët dhe vendet e reja të hapura nga investimet e huaja janë në sektorët e patregtueshëm, kryesisht pasuria e paluajtshme.

INVESTIMET NGA SHQIPËRIA, NË BAZË TË AKTIVITETIT EKONOMIK, NË VITIN 2016 ISHIN KRYESISHT NË PASURITË E PALUAJTSHME, NDËRMJETËSIMIN FINANCIAR, TREGTINË ME SHUMICË E PAKICË DHE INDUSTRI PËRPUNUESE.

Në vite, investimet që kanë dominuar, sipas prezantimit të znj. Jashari kanë qenë në fushën e pasurive të paluajtshme-ndërtim dhe ndërmjetësimit financiar. Në periudhën 2013-2016, investimet në pasuri të paluajtshme dhe ndërtim ishin përkatësisht 28.1 dhe 23.6 milionë euro dhe në ndërmjetësimin financiar rreth 20.3 milionë euro.

Ndërsa investimet nga Kosova në Shqipëri, në vitin 2016, ishin 15.6 milionë euro. Vlera më e lartë e investimeve nga Shqipëria në Kosovë sesa anasjelltas ngre pikëpyetjen nëse klima e investimeve në Shqipëri është më jo



favorizuese në raport me atë të Kosovës.

Për periudhën 2013-2016, investimet në pasuritë e paluajtshme nga Kosova në Shqipëri, që zënë peshën kryesore, ishin 23.8 milionë euro dhe në shërbime tregtare 7.2 milionë euro.

Nga Shqipëria në Kosovë ushtrojnë aktivitetin 903 biznese, ndërsa nga Kosova në Shqipëri rreth 600. Jashari tha se falimentimi i bizneseve nga Kosova në Shqipëri është një aktivitet normal, teksa ka një konkurrencë të lartë me bizneset greke e italiane.

Jashari shton se bizneset e Kosovës kanë më shumë probleme me lejet e ndërtimit dhe pagesën e taksave e tatimeve. “Investimet mes dy vendeve janë shumë më të ulëta se potenciali, pavarësisht përmirësimit të infrastrukturës”, tha znj. Jashari. Ajo shton se duhen përmirësuar procedurat doganore.

Avni Ponari, drejtues i kompanisë së sigurimeve Sigal thotë se edhe

Kosova dhe Shqipëria kanë të njëjtën natyrë, të njëjtën formë organizimi. “Industria e sigurimit sot, në të gjithë rajonin nuk është e zhvilluar. Sigurimet për frymë në Shqipëri janë 25 euro, në Kosovë 50 euro kurse në Kroaci 700 euro. Në Kosovë paguajmë një taksë për qarkullimin prej 5% dhe për shkak të kësaj takse, në Kosovë, sigurimet janë me humbje”, tha z. Ponari.

Ministri i Zhvillimit të Kosovës Blerand Stavileci tha se të dyja vendet kanë varësi të lartë nga importet dhe industri jo të zhvilluar. Bizneset synojnë fitime afatshkurtra dhe të shpejta, duke mos u përqendruar te industria prodhuese. “Duhet lidhje infrastrukturore që kanë shënuar përparime si në telekomunikacion, energji etj”, tha z. Stavileci.

Në lidhje me energjinë ai tha se kanë arritur marrëveshje me një kompani amerikane për të ndërtuar termocentralet me kapacitet 450 megavat. Ai u shpreh

optimist në lidhje me funksionimin e bursës së energjisë.

Irena Beqiraj, këshilltare e kryeministrit Edi Rama për ekonominë tha se Ballkani Perëndimor deri në vitin 2015 ka pasur investime kryesisht në shërbime. Investitori i huaj kërkon stabilitet makro, forcë pune të kualifikuar, siguri pune, si dhe stabilitet politik dhe jo sherre etnike.

Sipas saj, duhen unifikuar certifikatat dhe qeveria po punon për këtë.



THE SINGLE MARKET CHALLENGE, WHAT THE BUSINESS COMMUNITY WANTS



At the conclusion of the Aspiring to a Single Market, Albania-Kosovo Conference organized by AmChams in Albania and Kosovo, in cooperation with Monitor magazine, it was agreed that in addition to government cooperation, some sectoral agendas should be drafted and put into practice to boost current cooperation.

ALBANIA'S ECONOMY MINISTER MILVA EKONOMI SAID A THREE-YEAR AGENDA AGREED ON BETWEEN THE TWO GOVERNMENTS IS BEING IMPLEMENTED, ALSO COVERING SPECIAL DEMANDS BY BUSINESSES.

Albania and Kosovo are specifically cooperating on a joint negotiation process on the quota

agreements with CEFTA and the WTO.

Minister Ekonomi said plans are underway to organize joint trade fairs so that businesses on both sides of the border get to know the sectors they are interested in closer. The minister stressed the importance of the unification of customs declarations and easing the movement of special products.

Kosovo Trade and Industry Minister Hykmete Bajrami said that it often happens that barriers in customs offices or other aspects are a result of businesses not having the right information. She said both countries lack traditional trade links and in order to establish these bonds, she suggested that Albanian businesses should study the structure of Kosovo imports so that they can provide the market with those products currently imported. Minister Bajrami said

Kosovo has the region's lowest taxes and that Albanian businesses are welcome to invest in the manufacturing sector so that the local Kosovo market replaces some of the currently imported products.

Arian Zeka, the head of AmCham Kosovo, said he was not happy with the institutional dynamics of the cooperation and considered the joint drafting of a Kosovo-Albania investment

platform of vital importance. AmChams in the region already have it on the agenda. He also suggested overcoming political issues, calling for stronger cooperation in providing concrete solutions.

Edmond Leka, the Monitor magazine publisher, sees the creation of a single Albania-Kosovo market as the result of bilateral government-to-government and business-to-business cooperation. While cooperation at a government level is already tangible, Leka proposed closer correlation between businesses sectorally. He proposed the drafting of common agendas with a focus on getting to know the respective economies and cooperation opportunities in special sectors from trade to industry and finances.

The deputy chief of mission at the U.S. Embassy in Tirana, David Muniz, said the continuation of reforms is of vital importance in serving stronger cooperation. Mr. Muniz noted the implementation of the justice reform would further ease the business climate as a challenge for Albania, while at a regional level, he appreciated cooperation among regional countries, in both political and technical aspects, serving the single market.



SFIDA E TREGUT TË PËRBASHKËT, ÇFARË KËRKON BIZNESI

Në përmbyllje të punimeve të konferencës “Aspirata për një treg të përbashkët, Shqipëri-Kosovë”, organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë së Shqipërisë dhe Kosovës, në bashkëpunim me Revistën “Monitor” u ra dakord që përveç bashkëpunimit qeveritar të formulohen dhe të vihen në zbatim edhe disa axhenda sektoriale, ku bizneset e të dyja vendeve të jenë në fokus për të zgjeruar bashkëpunimin konkret.

MINISTRJA E EKONOMISË,

MILVA EKONOMI,
THA SE AKTUALISHT
ËSHTË NË VEPRIM NJË
AXHENDË TREVJEÇARE
E RËNË DAKORD MES DY
QEVERIVE, E CILA HYN
NË VEPRIM EDHE SIPAS
KËRKESAVE TË BIZNESEVE
TË VEÇANTA.

Veçanërisht Shqipëria dhe Kosova janë duke bashkëpunuar në një proces të përbashkët negociimi për marrëveshjet e kuotave me CEFTA-n dhe OBT-në.

Ekonomi tha se po hartohen plane për zhvillimin e përbashkët të panaireve me qëllim që bizneset e dy anëve të njohin sektorët që u interesojnë për bashkëpunim nga afër. Ministria e vuri theksin më shumë se sa tek unifikimi i përbashkët i deklarave doganore, tek lehtësimi i lëvizjes së produkteve të caktuara.

Ministrja e Ekonomisë së Kosovës, Hykmete Bajrami, tha se shpesh ndodh që barrierat në dogana apo aspekte të tjera vijnë për shkak se bizneset nuk e kanë informacionin e duhur. Ajo tha se dy shtetet nuk kanë lidhje tradicionale të tregtisë me njëra-tjetrën dhe për të krijuar këto lidhje, ajo sugjeroi që bizneset e Shqipërisë të studiojnë strukturën e importeve të Kosovës, në mënyrë që ata t'i japin tregut

ato produkte që sot importohen. Bajrami tha se Kosova ka taksat më të ulëta në rajon dhe se bizneset shqiptare janë të mirëpritura për të investuar në sektorin prodhues, në mënyrë që tregu vendas i Kosovës të zëvendësojë disa produkte që sot importohen.

Arian Zeka, drejtor i Odës Amerikanë të Tregtisë në Kosovë, tha se nuk është i kënaqur me dinamikën institucionale të bashkëpunimit dhe konsideroi shumë të rëndësishme krijimin e një platforme të përbashkët për investimet nga dy vendet. Dhoma Amerikane në rajon tashmë e kanë një axhendë të tillë. Por ai sugjeroi që të tejkalohen problemet politike duke bërë thirrje që bashkëpunimi të thellohet në aspektin e zgjidhjeve konkrete.

Edmond Leka, botues i Revistës “Monitor”, e sheh krijimin e tregut të përbashkët Shqipëri-Kosovë si rrjedhojë e një bashkëpunimi dyplanësh:

qeveri-qeveri dhe biznes-biznes. Teksa bashkëpunimi në rrafshin qeveritar është i njohur tashmë, Leka propozoi korrelacion më të ngushtë ndërmjet biznesit në rrafshin sektorial. Ai propozoi që të hartohen axhenda të përbashkëta me fokus njohjen e ekonomive përkatëse dhe mundësitë që kanë për bashkëpunim sektorë të veçantë që nga tregtia dhe deri tek sektorët e industrisë dhe financave.

Zëvendësambasadori amerikan i SHBA-së në Tiranë, David Muniz, tha se për t'i shërbyer bashkëpunimit është me rëndësi vijimësia e reformave. Për Shqipërinë, zoti Muniz renditi zbatimin e reformës për drejtësi, e cila do të lehtësonte më tej klimën e biznesit, ndërsa në rrafshin rajonal, ai vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit, si në aspektin politik dhe teknik në shërbim të tregut të përbashkët.



AmCham's General Assembly Meeting elects the President and two Board Members

AMCHAM PRESENTS ABI 2016-2017



The American Chamber of Commerce in Albania organized its General Assembly Meeting, where the chamber's President and two members of the Board

by AmCham Executive Director Enida Bezhanjani, who recently took the helm of the organization and was participating at her first major meeting as the new



of Directors were elected. The voting process led to the reappointment of Mark Crawford as AmCham President and to Enio Jaçodhe Brandt Hoffman taking seats on the Board of Directors.

The General Assembly is one of AmCham Albania's most important activities, serving as a venue to present the work done in the past year as well as presenting the AmCham Year Book and the findings of ABI, AmCham's Business Index.

The annual report was presented

by AmCham Executive Director Enida Bezhanjani, who recently took the helm of the organization and was participating at her first major meeting as the new

head of AmCham. The General Assembly Meeting allows the Board of Directors and staff to present the work of the chamber's members. The U.S. Ambassador and the Minister of Economy also use this annual event to address the AmCham members.

Ambassador Donald Lu told AmCham members he expects big things to happen in Albania in 2017.

During this year, 2017, Albania will finally address the issue of corruption at high levels

through the establishment of special anti-corruption structures and the National Bureau of Investigation, said Ambassador Lu. This year will also see large-scale international and domestic investment in Albania, according to Lu.

Ambassador Lu also reminded members of the tremendous work being done at all levels to finalize the judicial reform as a cornerstone in the rule of law that businesses expect before they decide to come and invest in Albania.

Lu added:

"2017 WILL BE AN EXCELLENT YEAR FOR ALBANIA. THIS IS THE YEAR WHEN ALBANIA STARTS IMPLEMENTING THE JUDICIAL REFORM, WHICH WILL FOREVER TRANSFORM THE BUSINESS ENVIRONMENT FOR ALL OF YOU."

Ambassador Lu noted that 2017 is a year of parliamentary elections too, which he said would put the country into a democratic course for four years of political stability and greater progress towards the European future of Albania. He added that "2017 will be the year in which the EU and the United States supports Albania's efforts to deal with the huge social challenge of organized crime and illicit drugs. It will also create greater opportunities for honest business owners."

On her address to the AmCham members, Minister of Economy Milva Ekonomi praised the role of AmCham in publishing the ABI. She explained that the government does read and reflect on the findings of the index and the messages that the business community sends through it. Minister Ekonomi added that the reforms undertaken by the government aimed at resolving precisely some of the issues raised by ABI.

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë zgjedh Presidentin dhe dy anëtarë Bordi

AMCHAM PREZANTON ABI 2016-2017



Dhoma Amerikane ka organizuar Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë, përmes së cilës ka zgjedhur Presidentin dhe dy anëtarë të Bordit Drejtues. Me shumicë votash, President i Dhomës Amerikane është zgjedhur z. Mark Crawford dhe anëtarë Bordi z. Enio Jaço dhe Brandt Hoffman.

Asambleja e Përgjithshme është një nga aktivitetet më të rëndësishme të Dhomës Amerikane, që shërben për të bërë bilancin e punës, prezantimin e 'Year Book' dhe ABI, (Indeksi e Biznesit të AmCham). Raporti vjetor është prezantuar nga Drejtorja e re Ekzekutive e Dhomës Amerikane, znj. Enida Bezhani, e cila ka patur dhe takimin e parë si drejtuese e Dhomës Amerikane.

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë është momenti i bilancit të punës që Bordi drejtues bën përpara anëtarëve të Dhomës. Pjesë e këtij rituali vjetor, është edhe Ambasadori Amerikan si dhe Ministri i Ekonomisë, të cilët shfrytëzojnë këtë format për t'i drejtuar përshëndetjet e tyre anëtarëve

të Dhomës Amerikane. Ambasadori Donald Lu u është drejtuar anëtarëve të Dhomës me optimizmin e diplomatit që pret ngjarje të mëdha për Shqipërinë në 2017-ën. "2017-a është viti kur Shqipëria më në fund do të zgjidhë konfliktin e korrupsionit në nivele të larta përmes krijimit të Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. 2017-a është viti kur do të shohim investime ndërkombëtare dhe të brendshme në shkallë të gjerë të vijnë në Shqipëri" – u shpreh Ambasadori Lu.

Në komunikimin e tij me anëtarët, z. Lu nuk ka harruar të shtojë edhe punën e madhe që po bëhet në të gjitha nivelet për të finalizuar reformën në drejtësi, si një gur themeli në drejtësi që bizneset e huaja presin kur vijnë në Shqipëri.

"2017-A DO TË JETË NJË VIT I SHKËLQYER PËR SHQIPËRINË. KY ËSHTË VITI KUR SHQIPËRIA NIS

ZBATIMIN E REFORMËS NË DREJTËSI, E CILA DO TA TRANSFORMOJË PËRGJITHMONË MJEDISIN E BIZNESIT PËR TË GJITHË JU."

2017-a do të jetë gjithashtu viti i zgjedhjeve parlamentare, që do ta vënë Shqipërinë në një kurs demokratik për katër vite stabiliteti politik dhe përparimi më të madh drejt të ardhmes evropiane të Shqipërisë. 2017-a do të jetë viti në të cilin BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara mbështesin përpjekjet e Shqipërisë për t'u përballur me sfidën e stërmadhe

shoqërore të krimit të organizuar dhe të drogave të paligjshme. Kjo do të krijojë mundësi edhe më të mëdha për biznesmenët e ndershëm" – tha Ambasadori Lu gjatë takimit me anëtarët e Dhomës.

Takimi është përshëndetur edhe nga Ministria e Ekonomisë znj. Milva Ekonomi, e cila vlerësoi rolin e AmCham-it në organizimin e ABI-t dhe mënyrës se si qeveria i lexon dhe reflekton nga këto mesazhe që i dërgon biznesi. Sipas znj. Ekonomisë, reformat që ka ndërmarrë qeveria synojnë pikërisht për të zgjidhur disa nga çështjet që ngrihen nëpërmjet pyetësorit tek ABI.



ABI INDEX UP FIVE POINTS YEAR-OVER-YEAR



The AmCham Business Index is one of the most important publications assessing the business climate in Albania. Presented by Lorenc Gjoni, the ABI findings showed that in the past year there had been a five-point increase compared to the previous year, reaching 43.78 percent from 37.9 percent a year ago.

Despite the improvement, analyzing in detail the findings of ABI 2016-2017 shows that 63.2 percent of businesses surveyed believe that the overall level of tax applied is very unfavorable or unfavorable, and 37 percent think it is favorable.

The truth is sometimes difficult to hear, but AmCham has always told the unvarnished truth about the investment climate in these past five years. The chamber is pleased to see this year an increase in investor confidence with growth recorded in the AmCham Business Index.

Indicators that have had the

greatest improvement, are “relations with tax authorities” and the “business climate,” which increased respectively by 12.3 and 11.2 points. In total, all indicators have been improving, with the exception of getting local staff, which has seen a slight decline.

The AmCham Business Index represents the perception of chamber members about the business climate in Albania. About 77 percent of businesses surveyed have more than 10 employees.

Despite the improvement, the index remains negative, since it is below the level of 50 percent that separates the border between positive and negative. About 44 percent of respondents think that the climate of doing business is very unfavorable or unfavorable, and only 18.5 percent think that it is favorable, with the rest remaining neutral in this indicator. The high level of taxes continued to be the main concern, with 30.45

points, a slight improvement from last year. And 63.2 percent of businesses surveyed believe that the overall level of tax applied is very unfavorable or unfavorable, and 37 percent think it is favorable. The tax level is the top concern among AmCham members, according to ABI.

The second largest concern is the government bureaucracy, a concern that was third last year. Only 5.9 percent of respondents think that government bureaucracy is very low, while 65.2 percent think that it is high or very high.

The third problem remains monopoly and unfair competition with 31.11 points. Also, 63.7 percent of respondents think that the level of monopoly and unfair competition is very high.

The business climate, which was the fourth biggest concern in last year’s index, has gone down to ninth. Improvement was also seen in perceptions of the domestic political climate (albeit the index was conducted in January, before the current conflict), economic reforms and policies

of the central government, relations with the fiscal authorities, order and security in the country and relations with customs authorities.

In this year’s survey, the percentage of those who think that the relationship with the tax authorities is bad or very bad is significantly lower, at 14 percent, while those who say that relations are good increased to 52.7. This is the best result seen since 2012, when AmCham published its first indicators index.

“I would like to congratulate the American Chamber of Commerce in Albania for the publication of the index. ABI provides important information for the state in terms of the investment climate situation, opportunities and challenges of doing business in Albania. Improving the business climate is crucial for creating jobs, economic growth and opportunities,” said U.S. Ambassador Donald Lu in his remarks on ABI 2016-2017.

ABI, INDEKSI RRITET ME PESË PIKË NGA VITI I KALUAR

ABI si një nga botimet më të rëndësishme dhe një Indeks që po merr vlera në vlerësimin e parametrave të klimës së biznesit, është prezantuar nga Lorenc Gjoni, i cili ka bërë një prezantim të gjetjeve të reja të ABI-t dhe faktorëve kryesorë që ndikuan në këtë rezultat. ABI 2016- 2017 ka patur një rritje prej pesë pikësh, duke shënuar një nivel Indeksi në 43.78 për qind nga 37.9 për qind që ishte një vit më parë.

Megjithatë, duke analizuar në detaje gjetjet e ABI-it për 2016-2017 mund të thuhet se 63.2% e bizneseve të anketuara mendojnë se niveli i përgjithshëm i taksave të zbatuara është shumë i pafavorshëm, ose i pafavorshëm dhe rreth 37% mendojnë se ai është i favorshëm...

“E vërteta ndonjëherë është e vështirë të dëgjohet. Dhoma Amerikane e Tregtisë ka thënë të vërtetën e pazbukuruar në lidhje me klimën e investimeve në këto pesë vite. Jam i kënaqur të shikoj në këtë vit një rritje në besimin e investitorëve me rritjen e shënuar në Indeksin e

Biznesit të AmCham-it (ABI). Treguesit, që kanë pasur përmirësimin më të madh, janë “marrëdhëniet me autoritetet fiskale” dhe ai i “klimës së biznesit”, që janë rritur përkatësisht me 12.3 dhe 11.2 pikë. Në total, të gjithë treguesit kanë ardhur në përmirësim, me përjashtim të gjetjes së stafit lokal, që ka shënuar një rënie të lehtë. Indeksi i Biznesit të Dhomës Amerikane përfaqëson perceptimin e anëtarëve të Dhomës lidhur me klimën e biznesit në Shqipëri. 77% e bizneseve të anketuara kanë më shumë se 10 punonjës. Pavarësisht përmirësimit, indeksi mbetet negativ, pasi ai është poshtë nivelit 50, që ndan kufirin mes pozitivës dhe negativës. Rreth 44% e të anketuarve mendojnë se klima e të bërit biznesit është shumë e pafavorshme, apo e pafavorshme dhe vetëm 18.5% mendojnë se ajo është e favorshme ndërkohë që pjesa tjetër qëndron neutral përballë këtij treguesi. Niveli i lartë i taksave të zbatuara ka vijuar të mbetet shqetësimi kryesor, me 30.45 pikë, me një përmirësim të lehtë nga viti

i kaluar. 63.2% e bizneseve të anketuara mendojnë se niveli i përgjithshëm i taksave të zbatuara është shumë i pafavorshëm, ose i pafavorshëm dhe rreth 37% mendojnë se ai është i favorshëm. Ky mbetet dhe shqetësimi i parë dhe më i madh i anëtarëve të Dhomës Amerikane.

Shqetësimi i dytë më i madh lidhet me burokracinë e qeverisë, tregues që një vit më parë ishte në vendin e tretë. Vetëm 5.9% e të anketuarve mendojnë se burokracia e qeverisë është shumë e ulët, 65.2% mendojnë se ajo është e lartë, ose shumë e lartë. Problemi i tretë mbetet monopoli dhe konkurrenca e pandershme, me 31.11 pikë. 63.7% e të anketuarve mendojnë se niveli i monopolit dhe konkurrencës së pandershme është shumë i lartë. Klima e biznesit, që ishte shqetësimi i katërt më i madh në indeksin e vitit të kaluar, ka kaluar në të nëntin. Përmirësim të lartë ka shënuar dhe klima e brendshme politike (indeksi është realizuar në muajin janar), reformat ekonomike dhe politikat e qeverisjes qendrore,

marrëdhëniet me autoritetet fiskale, rregulli dhe siguria në vend, marrëdhëniet me autoritetet doganore.

Në anketimin e këtij viti, përqindja e atyre që mendojnë se marrëdhëniet me autoritetet tatimore janë të këqija, ose shumë të këqija është ulur ndjeshëm, në 14%, ndërsa ata që pohojnë se marrëdhëniet janë të mira janë rritur në 52.7. Ky është rezultati më i mirë, që nga viti 2012, kur Dhoma Amerikane publikon treguesit e indeksit.

“Do të doja të përgëzoja Dhomën Amerikane të Tregtisë në Shqipëri për publikimin e indeksit. ABI siguron një informacion të rëndësishëm për shtetin për sa i përket gjendjes së klimës së investimeve, të mundësive dhe të sfidave të të bërit biznes në Shqipëri. Përmirësimi i klimës së biznesit është themelor për krijimin e vendeve të punës, rritjes ekonomike dhe mundësive” është shprehur z. Donald Lu në fjalën e tij përshëndetëse për ABI 2016-2017.







AMCHAM ARGUES AGAINST 'TAX EXPERTS' DRAFT LAW

BILL LACKS PUBLIC CONSULTATION, SETS MONOPOLIES

A draft law "On the Organization and Functioning of the Regulated Profession of Tax Expert and the Institute of Tax Experts" has prompted a reaction from the American Chamber of Commerce and a group of experts who are part of the AmCham Tax and Legal Committee, led by Alketa Uruci. The Chamber has presented the Ministry of Finance and the Ministry of Justice a long list of arguments that justify AmCham's opposition to the draft law and how it was charted. Ms. Uruci and a group of AmCham representatives also met Minister of Justice Petrit Vasili and Deputy Minister of Finance Ervin Mete to voice the Chamber's concerns. The discussions in the meetings led to an agreement that the bill should be withdrawn.

The draft law would have set up the Institute of Tax Experts, an organization that would have had supervision of all tax experts, be their individual or members in a working group, a move that would have given full authority on all tax advisors and experts to a single NGO -- the Institute of Tax Experts.

In official letters and meetings with government officials, AmCham showed

concern about the total lack of public consultation, which alone should be enough for the appropriate commission to refuse to approve the draft law.

Performing a deep analysis of the bill, AmCham found that the documents accompanying the draft law don't present any analysis, studies or even list the issues that might have popped up to produce a need to further regulate this profession in Albania. The major problem, according to AmCham, is limiting the services specified in the draft only to fiscal experts, excluding other professionals who currently perform these services. The Chamber opposes both the exclusivity and extensive number of services defined in the draft law. The bill also offers an overlap in regulation with the activity exercised by lawyers when providing fiscal consulting services as well as when representing clients in court. In addition, the draft law also creates overlaps in regulation for consulting services provided by legal auditors and approved accountants.

Based on findings, the services provided by tax experts are currently offered by legal auditors (of course, as long as there is no conflict of interest) as well as



approved accountants. AmCham notes that these two regulated professions should continue to provide these services without having to be licensed as tax experts, because their professions are regulated by law and are supervised by institutions that offer maximum safety for the services provided.

COMMENTS BY THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA ON THE DRAFT LAW "ON THE ORGANIZATION AND FUNCTIONING OF THE REGULATED PROFESSION OF TAX EXPERT AND THE INSTITUTE OF TAX EXPERTS"

The AmCham was informed by the three-week calendar of the Parliament's agenda regarding the proposal made by an MP on the drafting and approval of the draft law "On the Organization and Functioning of the Regulated Profession of Tax Expert and the Institute of Tax Experts."

The AmCham Tax and Legal Committee introduced the Chamber's comments to the parliamentary Finance and Economy Committee (summed up as follows).

1. LACK OF PUBLIC CONSULTATION

Such an important legal initiative not only for the sector it intends to regulate, but also for the effects it creates in already regulated professions would have

to undergo lengthy discussion in order to avoid issues (which in fact this draft law gives rise to).

The draft law would have to be discussed not only with businesses in

general but also the National Bar Association, the Institute of Chartered Auditors of Albania (IEKA), the Institute of Certified Accountants (IKM), the Accountants and Financiers Association

DHOMA AMERIKANE KUNDËR “EKSPERTIT FISKAL”

NUK KA KONSULTIM ME PUBLIKUN DHE VENDOS MONOPOLE NË TREG

Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Profesionit të rregulluar të Ekspertit Fiskal dhe Institutit të Ekspertëve Fiskalë” ka shkaktuar reagimin e Dhomes Amerikane të Tregtisë dhe grupit të ekspertëve, që janë pjesë e Komitetit të Taksave dhe Ligjeve, të drejtuar nga znj. Alketa Uruçi. Dhoma ka bërë prezente në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Drejtësisë një listë të gjatë me argumente që justifikojnë kundërshtimin e saj në lidhje me shyrëtimin dhe miratimin e këtij projektligji. Znj. Uruçi së bashku me një përfaqësi të Dhomes janë takuar edhe me Ministrin e Drejtësisë, z. Petrit Vasili, si edhe me Zëvendësministrin e Financave, z. Ervin Mete, ku pas diskutimeve në tavolinë kanë rënë dakord që projektligji duhet të tërhiqet.

Drafti parashikonte krijimin e Institutit të Ekspertëve Fiskalë” (IEF) një organizëm, që grupon të gjithë ekspertët fiskalë, persona fizikë dhe të gjitha shoqëritë e ekspertëve fiskalë të regjistruara në Regjistrin e Institutit të Ekspertëve Fiskalë të Shqipërisë, por që u konsiderua si një lëvizje që vendos kontroll mbi profesionin e këshilltarit tatimor

dhe i jep autoritet të plotë një OJF-je të vetme, pikërisht Institutit të Ekspertëve Fiskalë.

Në letrat zyrtare dhe në takimet me autoritete, Dhoma Amerikane ka paraqitur shqetësimin për mungesën totale të konsultimit publik, një element ky i mjaftueshëm për Komisionin që të refuzojë miratimin e këtij projektligji.



Duke i bërë një analizë më të thellë projektligjit, Dhoma Amerikane gjykon se relacioni që shoqëron projektligjin nuk paraqet asnjë analizë, studim apo dhe thjesht problematikat që mund të jenë shfaqur, që të ketë krijuar nevojën për rregullimin e këtij profesioni në Sh-

qipëri. Problematika më e rëndësishme, thekson Dhoma, është kufizimi i shërbimeve të përcaktuara në projektligj vetëm për ekspertët fiskalë, duke përjashtuar profesionistët e tjerë që aktualisht i kryejnë këto shërbime. Dhoma kundërshton si ekskluzivitetin, ashtu edhe numrin e gjerë të shërbimeve që përcaktohet në projektligj. Drafti ka dhe mbivendosje me aktivitetin e ushtruar nga avokatët përse i takon përfaqësimit në gjyq të klientëve si dhe ofrimit të shërbimeve të konsulentëve fiskalë, si edhe ka mbivendosje me shërbimet e konsulentëve fiskalë të ofruara nga auditues ligjorë dhe kontabilistë të miratuar.

Rezultoni se shërbimet që do të ofrohen nga ekspertët fiskalë, aktualisht ofrohen nga auditues ligjorë (sigurisht sa kohë auditori nuk gjendet në konflikt interesi) si dhe nga kontabilistë të miratuar. Dhoma thotë se të dy këto profesione të rregulluar duhet të vazhdojnë t'i ofrojnë këto shërbime pa patur nevojë që të licensohen si Ekspertë Fiskalë, pasi profesionet e tyre janë të rregulluara me ligj dhe janë të mbikëqyruar nga institucione që ofrojnë sigurinë maksimale për shërbimet e ofruara.

**KOMENTE TË DHOMËS
AMERIKANE TË TREGTISË
MBI PROJEKT-LIGJIN
“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E PROFESIONIT
TË RREGULLUAR TË EKSPERTIT
FISKAL DHE INSTITUTIN E
EKSPERTËVE FISKALË”**

Dhoma Amerikane u vunë dijeni nga kalendari tre-javor i punimeve të Kuvendit lidhur me propozimin e paraqitur nga një deputet për hartimin dhe miratimin e projekt-ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Profesionit të Rregulluar të Ekspertit Fiskal dhe Institutin e Ekspertëve Fiskalë”.

Komiteti i Taksave dhe Ligjeve të Dhomes Amerikane paraqiti komentet e Dhomes pranë Komisionit të Financave dhe Ekonomisë (përmbledhtazi si më poshtë).

1. MUNGESA E KONSULTIMIT PUBLIK

Një iniciativë ligjore kaq e rëndësishme jo vetëm për sektorin që synon të rregullojë, por edhe për efektet që krijon në profesionet tashmë të rregulluara do të

duhej të diskutohej gjatë paraprakisht në mënyrë që të shmangen problematikat (që në fakt ky projektligj i krijon). Projekt-ligji do të duhej të diskutohej jo vetëm me bizneset në përgjithësi,

por edhe me Dhomen Kombëtare të Avokatëve, IEKA (Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar), IKM (Institutin e Kontabilistëve të Miratuar), SHKFSH (Shoqata e Kontabilistëve dhe Financi-

of Albania (SHKFSH), the Tax Council of the Ministry of Finance and other important stakeholders in drafting and implementing tax legislation.

The ministries of finance and justice would have to play a key role in assessing such an initiative as the overlap of the “tax expert” proposed in the draft law with regulated professions such as the lawyer, the authorized accounting expert or the certified accountant (who are supervised by these two ministries) risks monopolizing the market and increasing service fees for businesses.

2. THE NEED TO ADOPT THE DRAFT LAW ON TAX EXPERTS

The explanatory report accompanying the draft law introduces no analysis, study or issues that could have arisen leading to the need to regulate this profession in Albania. The argument brought is the obligation introduced in 2012 to submit personal income statements as a legal change that would create a market for these services. In fact, it is not about a number of 500,000 taxpayers as claimed, but only 10,000 to 12,000 ones, mainly employed and with a simple declaration form. Likewise, the entry into force of the new VAT law has not encountered any problems that make such intervention necessary.

3. THE EXCLUSIVENESS IN OFFERING THE TAX CONSULTANCY SERVICES

The main issue that arises is the limitation of services determined in the draft law only to tax experts, excluding other professionals currently offering these services.

In addition to the fact that the “tax expert” title turns into a title reserved to the profession, it also offers “exclusiveness” in providing a broad number of services.

We oppose both the exclusive rights and the big number of services determined in the draft law.

The proposed law is based on a division that should be made to services offered

by the tax expert.

Practically, but also theoretically, the accounting and audit services, but even legal ones cannot have a clear-cut division. The dividing line in such issues is invisible and consultancy overlaps, making the proposed law inapplicable.

Whatever the division of services (i.e. market) between lawyers, accounting experts, certified accountants and tax experts, it will burden a specific or several professions while incentivizing another/others.

- a) The overlap with the activity carried out by lawyers regarding the customers’ representation on trial and the provision of tax consultancy services

This draft law determines that “tax expertise – involves ... representing and



defending taxpayers before administrative bodies and courts...”

This provision runs counter to the legal regulation of the lawyer’s profession.

Legal counseling which has no limitations in the field of law, i.e. it involves even tax consultancy (in the form of tax consultancy) and the customer’s representation in court are currently offered by lawyers who carry out this profession being licensed and regulated by the Bar Association.

In addition, the lawyers’ right to represent customers before court is also sanctioned in the Constitution and the Civil and Criminal Procedures codes, where a lawyer’s rights to represent and defend the customer before court are clearly defined.

No other profession, be it also a regulated one, can carry out and replace the lawyer’s role for reasons related to the lawyer’s professional background, enabling the protection of the customers’ interests.

The tax consultancy offered by lawyers cannot be replaced by the services offered by tax experts. The latter can have knowledge in commercial and tax law but this does not make them able to understand the interaction of the tax and commercial law with other laws and their real effects on the customer.

- b) The overlap with the tax consultancy services offered by legal auditors and certified accountants

Resulting from other laws, the services that will be offered by tax experts are currently offered by legal auditors and certified accountants.

Both of these regulated professions should continue providing these services without needing to be licensed as tax experts, because their professions are regulated by law and supervised by institutions, offering maximum security for services provided.

Likewise, the special law determines that the condition to obtain the legal auditor title (accounting expert) is a professional

